

Informacione për prindërit dhe punonjësit e fushës së formimit në kantonin e Vaudit – Koronavirusi (Covid-19)

Përditësim i informacionit

Kjo faqe, që u kushtohet qendrave të formimit, shkollave dhe institucioneve të pritjes kolektive ditore para dhe pas-shkollore, përditësohet sipas zhvillimit të gjendjes.

Versioni i 1 majit, ora18.00.

Përse janë mbyllur qendrat e formimit ?

Përballë zhvillimit të gjendjes, kantoni i Vaudit, në konsultim me Këshillin Federal, ka marrë masa të jashtëzakonshme e të papara ndonjëherë në mbrojtje të njerëzve me rrezik, ata të moshës mbi 65 vjeç, dhe në mbështetje të sistemit shëndetësor. Duke filluar nga e hëna 16 mars, nxënësit e shkollës së detyrueshme dhe të mesme, studentët dhe arsimtarët nuk shkojnë më në vendin e formimit, por qëndrojnë në shtëpi, me qëllim që të luftohet kundër përhapjes së virusit. E njëjta gjë vlen edhe për nxënësit në formim profesional në ditët e mësimi. Është me shumë rëndësi që sa më shumë njerëz të qëndrojnë në banesat e tyre. Për të mbështetur sistemin shëndetësor, në çdo qendër të arsimit të detyrueshëm do të ketë një shërbim të pritjes shkollore nga ora 7.00 deri në orën 18.30.

A do të vazhdojnë mësimet ?

Po, por në largësi. Ato do të rifillojnë në klasa më 11 maj.

Saktësime të mëtejshme :

- [Vendimi n° 166 : « Dispozitat për vënien në jetë të mësimi në largësi për arsimin e detyrueshëm \(COVID 19\) » të 24 marsit 2020 \(PDF, 151 Ko\)](#)
- [Vendim i 23 marsit 2020 mbi masat shoqëruese në fushën e arsimit të detyrueshëm që synojnë zbutjen e pasojave të masave të mara për të luftuar koronavirusin \(COVID 19\) PDF, 31 Ko\)](#)

Si funksionon shërbimi i pritjes shkollore?

Me klasa me jo më shumë se 9 nxënës dhe në përputhje të plotë me rregullat e OFSP-së. Qendrat përkatëse furnizohen me sapun të lëngshëm e shami duarsh të hedhshme dhe po

që nevoja edhe me lëng hidro-alkoolik. Puna e shërbimit të pritjes bashkërendohet edhe me strukturat pas-shkollore. Shërbimi i pritjes sigurohet edhe gjatë pushimeve shkollore.

Cilët janë prindërit që mund të përfitojnë nga shërbimi i pritjes shkollore?

Urdhëresa e Këshillit federal që ka hyrë në fuqi më 17 mars 2020 (Ordonnance 2 COVID-19, art.5 al. 3) cakton masa të reja që synojnë të përmbajnë sa më parë përhapjen e sëmundjes, të mbrojnë njerëzit më të prekshëm e të ndërmarrin gjithçka për të shmangur rrënimin e sistemit shëndetësor.

Disa punonjës-e duhet të vazhdojnë të shkojnë në vendin e tyre të punës. Në këtë rast, përparësi i jepet krijimit nga punëdhënësi i mundësisë për të punuar në largësi, si dhe zgjidhjes së problemit të mbajtjes së fëmijëve në kuadrin vetjak e të punës. Kur kjo është e pamundur, **ngaqë prindërit nuk arrijnë të gjejnë vetë zgjidhje për mbajtjen e fëmijëve të tyre, në dispozicion vihet një shërbim i pritjes shkollore. Kjo detyrë nuk mund t'u besohet njerëzve me rrezik të veçantë.** Ky shërbim vihet në dispozicion të prindërve që janë :

- punonjës të sistemit shëndetësor ;
- punonjës të burgjeve, punonjës të sigurisë të rekuizuar dhe punonjës të ngarkuar me detyrat themelore të Shtetit ;
- punonjës që janë të detyruar të punojnë në dyqanet ushqimore dhe ato të mallrave të nevojës së parë ;
- punonjës të shërbimit të pritjes shkollore.

Këta prindër duhet të paraqesin nevojat për mbajtjen e fëmijëve të tyre pranë sekretarisë së institucionit në të cilin fëmijët shkollohen. Çdo fëmijë duhet të marrë ushqim me vete për vaktin e drekës.

Saktësime të mëtejshme :

- [Vendimi n° 167 : « Dispozita për ngritjen e shërbimit të pritjes shkollore \(SAS\) \(COVID 19\) » \(PDF, 139 Ko\)](#)
- [Shërbimi i pritjes shkollore \(PDF, 168 Ko\)](#)

Si të sillemi në qendrat vaudeze të formimit ?

PROTECT YOURSELF AND OTHERS 

Keep your distance. 

Recommendation: If it's not possible to keep your distance, wear a mask. 

Continue to work from home if possible. 

STILL IMPORTANT:

 **Wash your hands thoroughly.**

 **Avoid shaking hands.**

 **Cough and sneeze into a tissue or the crook of your arm.**

 **Stay at home if you experience symptoms.**

 **Always call ahead before going to the doctor's or the emergency department.**

www.foph-coronavirus.ch



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Confederation

Bundesamt für Gesundheit BAG
Office fédéral de la santé publique OFSP
Ufficio federale della sanità pubblica UFSP
Uffizi federal da sanadad publica UFSP



Scan for translation

Këshillat bazë, që u rikujtohen të gjithë nxënësve dhe tërë punonjësve të pranishëm që sigurojnë shërbimin e pritjes shkollore në qendrat e formimit dhe që vihen në dukje në të gjitha institucionet me anën e afishes zyrtare të OFSP-së, janë si më poshtë :

- është e nevojshme të lahen duart rregullisht e me kujdes, me ujë e sapun;
- duhet të shmangët shtrëngimi i duarve ;
- duhet të mbahen largësitë / të shmangën kontaktet fizike të afërta;
- të rriturit dhe arsimtarët mund të venë maska në rast se nuk mund të mbajnë largësitë ;
- duhet kollitur e tështitur në shami ose në të thelluarën e bërrylit ;
- në rast të pranisë së shenjave (ethe e kollë), i rrituri apo fëmija i prekur duhet të rrijë në banesë. Në rast rëndimi të shenjave, ai kontakton mjekun trajtues.

Kthimi në shërbimin e pritjes shkollore i dikujt që ka qenë i sëmurë bëhet vetëm pas shërimit të plotë të tij, 24 orë pas zhdukjes së shenjave (ethe e kollë). Në rast rezultati pozitiv të testit, referojuni rubrikës pyetje-përgjigje (FAQ) të Mjekut kantonal.

[Sit për](#) këshillat dhe telengarkimin e afishes « Koronavirusi i ri : ja si të mbrohemi »

Për ç'arsye kthimi në klasa i nxënësve të arsimit të detyrueshëm është parashikuar për në 11 maj ?

Këshilli federal dha më 29 prill dritën e blertë për rifillimin e mësimit në klasa. Ky është një lajm i mirë për arsimin. Sidoqoftë, ky kthim mund të bëhet vetëm duke zbatuar me rreptësi masat sanitare. Shëndeti mbetet përparësia jonë.

Plani i mbrojtjes i OFSP-së thotë se fëmijët sëmuren shumë më rrallë se të rriturit, se ata paraqesin pak shenja dhe se për ata sëmundja është benine. Ata nuk luajnë gati asnjë rol në përhapjen e virusit.

Për më tepër informacione :

- [Vendimi n° 170 "Dispozita për zbatimin e masave sanitare dhe organizative në kuadrin e rifillimit hap pas hapi të arsimit me prani në klasë \(Plani i mbrojtjes kantonale - COVID-19\)" \(PDF, 173 Ko\)](#)

Për çfarë shërben kthimi në klasa ?

Kthimi në klasa mundëson rikrijimin e lidhjes shoqërore, rivendosjen e kontaktit me klasën, shokët, me arsimtarin dhe sistemin shkollor. Kjo mundëson rivendosjen e njëfarë barazie të mundësive midis nxënësve, sepse në mësimin në largësi, ashtu si në periudhat e pushimeve, theksohen pabarazitë midis atyre që i kanë aftësitë, mjetet dhe inkuadrimitin e duhur dhe atyre që nuk i kanë sa duhet këto.

Kthimi në klasa mundëson gjithashtu identifikimin e nxënësve që do të kenë vuajtur më shumë nga ndërprerja e mësimeve në klasë dhe punën me ta. Po ashtu, programi është mirëmenduar që të forcojë njohuritë që janë të rëndësishme për vazhdimin e rrugëtimit shkollor, gjë që e ndihmon edhe Departementin në përgatitjen e vitit shkollor 2020-2021.

Për më tepër informacione:

- [Letër drejtuar prindërve dhe nxënësve - 30 prill 2020 \(PDF, 133 Ko\)](#)

Si do të bëhet kthimi në klasa ?

Kthimi hap pas hapi kryhet me gjysmë-klasa nga e hëna 11 maj deri të mërkurën 20 maj (deri në festën e të Shëlbuemit - Ascension) për të dy ciklet e para (1-8P). Pas "Ascension"-it, duke filluar nga 25 maji, rifillimi i mësimet për 1P - 8P bëhet me klasa të plota.

Për ciklin e 3të (9-11P), rifillimi, gjatë tri javëve (e hënë 11 maj-e premte 29 maj), bëhet me gjysmë-klasa. Gjendja do të vlerësohet për të kaluar në klasa të plota duke filluar nga e hëna 1 qershor.

Ç'rregulla sanitare duhet të zbatohen nxënësit dhe punonjësit e fushës së arsimit duke filluar nga 11 maji ?

- Ata duhet të lajnë duart kur të arrijnë në shkollë, si dhe pas pushimit të mëngjesit dhe atij të pasdites. Nëse nuk ka duarlarëse, mund të përdorin lëngun hidro-alkoolik nën mbikëqyrjen e një të rrituri ;
- Duhet të kolliten e të teshtijnë në shami ose në të thelluarën e bërrylit ;
- Fëmijët dhe të rriturit duhet të mbajnë një largësi prej 2 metrash midis tyre, ashtu si edhe të rriturit midis tyre. Përkundrazi, nuk ka rregull që të përcaktojë largësinë midis fëmijëve, të cilët sidoqoftë duhet të kufizojnë kontaktet fizike midis tyre : duke shmangur shtrëngimin e duarve e duke bërë vetëm një prekje me bërryl - « check » ; duke mos u përqaftuar; duke u dhënë pëparësi lojrave dhe veprimtarive fizike pa kontakt.

Për më tepër informacione :

- [Vendimi n° 170 "Dispozita për zbatimin e masave sanitare dhe organizative në kuadrin e rifillimit hap pas hapi të arsimit me prani në klasë \(Plan i mbrojtjes kantonale - COVID-19\)" \(PDF, 173 Ko\)](#)

Ç'masa janë marë për mbrojtjen e punonjësve të arsimit duke filluar nga 11 maji ?

- Në sportelet e sekretarive të shkollave dhe të sekretarive rajonale të PPLS-ve, janë vendosur pllakata plastike të tejkshme ;
- Vendet e punës janë sistemuar në mënyrë të tillë që të ruhet largësia prej 2 metrash midis të rriturve në sallat e mësuesve. Edhe hyrja në to bëhet me radhë ;
- Për raste të veçanta apo me kërkesë, vihen maska në dispozicion ;
- Koshat e mbeturinave zbrazen një herë në ditë e nuk lihen asnjëherë pa kapak, edhe nëse kemi vetëm një karton të thjeshtë apo qese plastike ;
- Shpërndarja e materialeve duhet të bëhet prej nxënësve, në vend të mësuesve ;
- Të rriturit dhe fëmijët nuk duhet të ndajnë ushqimin midis tyre.

Në ç'kushte kryhen pushimet dhe dalja nga mësimi, duke filluar nga 11 maji ?

1P deri në 8P: pushimi kryhet me radhë për të shmangur grumbullimet e mëdha.

9S - 11S: nxënësit dalin në të njëjtën kohë dhe ndahen gjeografikisht në oborr. Ata nuk duhet të dalin nga zona që i është caktuar grupit / klasës së tyre në oborr.

Kur mbarojnë mësimet, të gjithë nxënësit largohen menjëherë nga oborri. Prindërit që vijnë t'i presin duhet të shmangin grumbullimin në afërsi të shkollës.

A do të dezinfektohen klasat dhe ndërtesat ?

Duke filluar nga 11 maji, do të bëhet dezinfektimi i klasave të paktën 2 herë në ditë, pikërisht i lokaleve, sipërfaqeve, tavolinave, dorezave të dyerve e dritareve, parmakëve të shkallëve, banjave dhe aparateve të përbashkëta të sallës së mësuesve. Materiali që nuk do të mund të lahet apo të dezinfektohet do të hiqet (çiltetë, tapetet, lodrat prej cohe, etj.).

Në hyrje të sekretarive, të sallave të mësuesve, bibliotekave dhe vendeve të tjera publike apo hapësirave të përbashkëta, do të vendosen paisje të posaçme shtesë për higjienën e duarve. Në rast pamjaftueshërie të duarlarësve në ndërtesë, nxënësit mund të përdorin lëng hidro-alkoolik nën mbikëqyrjen e një të rrituri.

Kush e kontrollon zbatimin e gjithë këtyre masave ?

Drejtoritë e shkollave janë të ngarkuara të verifikojnë zbatimin e të gjitha masave sanitare, nën autoritetin e prefektëve ose mjekut kantonal të cilit mund t'i drejtohen gjithashtu.

A do të hapen menecat, restorantet shkollore dhe sallat e studimit të mbikëqyrur duke filluar nga 11 maji ?

Ato do të hapen, por nxënësit e vitit të 9^e duhet të zbatojnë disa rregulla të posaçme higjienike : si për shembull të shkojnë në sallë me grupe e jo në të njëjtën orë. Studimi i mbikëqyrur do të rifillojë duke iu nënshtruar të njëjtave rregulla të higjienës dhe largësisë si edhe shkolla.

A do të kryhen transportet shkollore si zakonisht duke filluar nga 11 maji ?

Transportet shkollore do të duhet të rivendosen më 11 maj. Rregullat sanitare që duhet të zbatohen gjatë transportit do të përcaktohen prej specialistëve të fushës përkatëse.

Ç' duhet bërë, duke filluar nga 11 maji, nëse dikush (nxënës apo arsimtar) paraqet shenja në klasë ?

Në rast kolle (përgjithësisht të thatë), dhembje fyti, pamjaftueshëri në frymëmarrje, ethe, ndijim ethesh, dhembje muskulare, humbje të papritur të nuhatjes/ose shijes, dhembjes së kokës, shenjave gastro-intestinale, të konjonktivitetit apo rrufës, nxënësi:

- del nga klasa ;
- pajiset me maskë ;
- pret prindërit e vet ose kthehet në shtëpi (sipas moshës) ;
- prindërit kontaktojnë mjekun e fëmijëve ose "hotline"-ën e Kantonit.

Punonjësi i arsimit:

- del nga klasa ;
- pajiset me maskë ;
- kthehet në shtëpi ;
- kontakton mjekun e vet ose "hotline"-ën e Kantonit.

Si do të bëhet vlerësimi i vitit tim shkollor ?

Nuk do të ketë më nota. Shkolla vaudeze është e palëkundur për sa u përket masave sanitare, por mirëkuptuese në planin pedagogjik e të rrugëtimit shkollor. Kushtet e promovimit, orientimit, riorientimit dhe çertifikimit janë zbutur. Për promovimin e nxënësve të klasave 4P - 5P, 6P - 7P, 8P - 9S, 9S - 10S dhe për çertifikimin e klasave 10S - 11S :

- Mesataret e semestrit të parë krahasohen me ato të 13 marsit dhe mbahet parasysh gjendja e përgjithshme më e favorshme për nxënësin ;
- në të gjitha "*rastet "limite"*" (kur nxënësi nuk e arrin për fare pak mesataren), nxënësi e merr vitin ;
- Në rast ngeljeje, ende ka mundësi të merret një vendim nga këshilli drejtues i cili analizon në mënyrë të tërësishme gjendjen e merr parasysh sjelljen qysh nga rifillimi.

Për orientimin në VP apo VG, nuk ka raste "limite" apo të diskutueshme. Por sidoqoftë, kushtet janë lehtësuar sepse edhe këtu merret mesatarja më e favorshme për nxënësin, ajo e 13 marsit ose ajo e semestrit të 1rë.

Saktësime të mëtejshme :

- [Vendimi n° 171 : « Dispozita për nxënësit e shkollës së detyrueshme, që rregullojnë modalitetet e jashtëzakonshme të promovimit, orientimit, riorientimit, çertifikimit dhe pranimit në klasat e rakordimit dhe në shkollat e kulturës së përgjithëshme e të tregtisë, të gjimnazeve apo të maturës profesionale \(COVID-19\) » \(PDF, 150 Ko\)](#)

A do të zhvillohen provimet e fundit të shkollës (viti i 11ë)?

Këshilli i Shtetit ka vendosur anulimin e provimeve përfundimtare të çertifikatës së përfundimit të studimeve të shkollës së dytë (viti i 11ë) në vijim të masave të mara më parë.

Kushtet e marrjes së çertifikatës :

- Mbahet parasysh mesatarja më e favorshme për nxënësin (në semestrin e 1rë ose më 13 mars) ;
- Rastet “limite” çertifikohen kryesisht ;
- Në rast ngeljeje, ende ka mundësi të merret një vendim nga këshilli drejtues i cili analizon në mënyrë të tërësishme gjendjen e merr parasysh sjelljen qysh nga rifillimi.

ECR-të anulohen dhe vendimet për promovimin, orientimin dhe riorientimin merren në bazë të rezultateve të arritura vetëm me prani në klasë.

Saktësime të mëtejshme :

- [Vendimi n° 171 : « Dipozita për nxënësit e shkollës së detyrueshme, që rregullojnë modalitetet e jashtëzakonshme për promovimin, orientimin, riorientimin, çertifikimin dhe pranimin në klasat e “rakordimit” dhe në shkollat e kulturës së përgjithëshme e të tregtisë së gjimnazeve apo maturave profesionale \(COVID-19\) » \(PDF, 150 Ko\)](#)
- [Vendimi n° 166 : « Dispozita për vënien në jetë të mësimdhënies në largësi në arsimin e detyrueshëm \(COVID 19\) » të 24 marsit 2020 \(PDF, 151 Ko\)](#)
- [Vendim i 23 marsit 2020 mbi masat shoqëruese në fushën e arsimit të detyrueshëm që synojnë zbutjen e pasojave të masave të mara për të luftuar koronavirusin \(COVID 19\)](#)
- [Letër drejtuar prindërve dhe nxënësve « Mësimi në largësi duke filluar nga 27 prilli 2020 – Heqja e provimeve të vitit të 11ë» \(PDF, 240 Ko\)](#)

Nuk e kam gjetur ende projektin tim profesional, jam në vitin e 11ë dhe po filloj të shqetësohem. Kush mund të më ndihmojë në këtë gjendje kaq të veçantë ?

Për nxënësit në përfundim të rrugëtimit shkollor që janë zhytur në pasiguri për sa i përket të ardhmes së tyre profesionale, Zyra kantonale e orientimit shkollor e profesional (OCOSP) është në dispozicion për të shpjeguar sistemin e formimit, për të ndihmar fëmijët në bërjen e zgjedhjeve profesionale, për të bërë bilancin e gjendjes së tyre dhe për t'i mbështetur, në rast nevojë, në bërjen e kërkesës së tyre për të përfituar nga një zgjidhje kalimtare për vitin e ardhshëm shkollor. (2020-21). Këto masa mbështetëse për integrimin në formimin profesional (CFC/AFP) shoqërojnë të rinjtë në përpilimin e një projekti profesional (zgjedhje profesioni, përkryerje shkollore, kërkim të një vend formimi, etj.). Formulari i pranimit në një masë kalimtare¹ dhe shpjegimet gjenden në [faqet e OCOSP-së](#).

Duke filluar nga 11 maji, fëmija im do të shkojë në shkollë një ditë po një ditë jo, e unë nuk do të kem zgjidhje për mbajtjen e tij. Si t'ia bëj ?

Shërbimi i pritjes shkollore (SAS) do të mbahet pikërisht për këto raste deri më 22 maj për nxënësit nga 1P deri në 8P prindërit e të cilëve punojnë e nuk kanë zgjidhje për mbajtjen e tyre. Prindërit duhet t'i komunikojnë institucionit shkollor datën apo datat në të cilat fëmijët e tyre do të shkojnë në SAS.

Për nxënësit e viteve 9S - 11S, nuk do të ketë SAS. Në rast nevojë, përparësi do t'i jepet pritjes në klasë apo ndonjë zgjidhjeje tjetër të propozuar prej shkollave.

Si t'ia bëj nëse jam njeri i prekshëm apo kur jetoj me një a më shumë njerëz të prekshëm ?

Në këtë rast, shkolla do t'ju informojë me anën e [këtij formulari \(DOC, 43 Ko\)](#) që do t'ju lejojë të lajmëroheni dhe do t'i mundësojë nxënësit marrjen e mësimëve në largësi. Kthimi në shkollë do të jetë i mundur në një kohë të dytë dhe po qe se plotësohen kushtet sanitare të posaçme.

Për punonjësit e formimit: po hartohet një direktivë në bashkëpunim me Shërbimin e personelit të Shtetit të Vaudit e pas këshillimit me sindikatat.

Për më tepër informacione:

- [Deklaratë vetjake: nxënës i prekshëm apo që jeton me një njeri të prekshëm \(document Word\) \(DOC, 43 Ko\)](#)
- [Cilët janë njerëzit e prekshëm ? \(Sipas Urdhëresës 2 COVID-19 të Këshillit federal\)](#)

Unë punoj në një qendër formimi; kush do të m'i mbajë fëmijët, gjatë kohës që jam në punë ?

Fëmijët përkatës përfitojnë nga shërbimi i pritjes shkollore në qendrën e tyre arsimore nga ora 7.00 deri në orën 18.30 për sa i përket arsimit të detyrueshëm.

Unë punoj në shërbimin shëndetësor e prania ime atje është e domosdoshme. Nuk kam mundësi të qëndroj në banesë me fëmijët e mi; si t'ia bëj ?

Për të mos penguar veprimet e ndërmarra në kuadrin e luftës kundër virusit, fëmijët përkatës përfitojnë nga shërbimi i pritjes shkollore, në shkollën e tyre, nga ora 7.00 deri në orën 18.30, për sa i përket shkollës së detyrueshme.

Kur do të hapen institucionet e arsimit të mesëm (gimnazet, shkollat profesionale...) ?

Ato do të rinisin mësimet në klasë duke filluar nga 8 qershori, në përputhje me kërkesat e Konfederatës. Deri atëherë, do të vazhdojë mësimi në largësi. Notat janë pezulluar, sasia e punës është përshtatur me rrethanat dhe shpërndahen mjete numerike të mësimdhënies.

Për më tepër informacione:

- [Vendimi n° 169 : « Dispozita për ngritjen e mësimdhënies në largësi në arsimin e mesëm \(COVID 19\) » \(PDF, 258 Ko\) \(PDF, 258 Ko\)](#)

A do të ketë provime për maturën gjimnaziale e cilat do të jenë kushtet për marrjen e tyre ?

Provimet me gojë e me shkrim të maturës gjimnaziale janë anuluar. Nxënësit do ta marrin maturën në bazë të rezultateve të vitit të fundit mësimor të kryer. Nxënësit ngelës mund të paraqiten në një sesion në gusht për të ridhënë provimet në degët që zakonisht u nënshtrohen provimeve.

A do të mbahen provimet e nxënësve të formimit profesional ?

Kantoni ka qenë shumë aktiv për gjetjen e një zgjidhjeje kombëtare :

- provimet për pjesën teorike (aftësitë vepruese dhe kultura e përgjithëshme) janë anuluar për të gjitha profesionet në nivel kombëtar ;
- për provimet e pjesës praktike të formimit, autoritetet federale kanë përcaktuar procedura kualifikimi të diferencuara sipas profesioneve, duke u lënë kantoneve mundësinë për të paraqitur përjashtimet për sektorët në të cilët organizimi i një provimi nuk ka qenë i mundur për arsye sanitare. Kantoni i Vaudit ka nxjerrë rreth dyzet përjashtime (si për shembull tregtia, shëndeti, dega shoqërore, ndërtimi dhe

mekanika). Nëse doni të dini gjendjen për rrugëtimin tuaj shkollor, mund të kontaktoni institucionin tuaj apo të thërrisni [shërbimin e gatshëm telefonik](#).

A duhet të shkojnë në vendin e punës nxënësit në formim profesional ?

Nxënësit në formim profesional qëndrojnë në shtëpi dhe, në ditët që duhet të ishin në shkollë, kalojnë në mësimdhënien në largësi. Në ditët e tjera, ata shkojnë në vendin e punës, veç nëse punëdhënësi u jep udhëzime të kundërta me këto. Misioni i mbikëqyrjes i 65 komisarëve profesionistë është përforcuar me qëllim që të forcohet siguria e nxënësve në vendin e punës.

Saktësime të mëtejshme :

- [Vendimi n° 168 : « Mobilizimi i komisarëve profesionsitë për ushtrimin e mbikëqyrjes së kushteve të punës të nxënësve në vendin e punës sipas porosive të Zyrës federale të shëndetit publik \(OFSP\) në kuadrin e punës kundër koronavirusit COVID 19 » \(PDF, 246 Ko\)](#)

A do të ketë provime për maturën profesionale e cilat do të jenë kushtet për kalimin e tyre ?

Këshilli federal njoftoi, më 29 prill, heqjen e provimeve përfundimtare të maturës profesionale. Përfundohen vetëm degët e përfunduara tërësisht e për të cilat tashmë janë dhënë provimet përfundimtare. Pra, nxënësit do ta marrin maturën profesionale në bazë të notës së « shkollës » që përkon me mesataren e notave të mara në secilën degë gjatë semestrit të ndjekur në shkollë.

Nxënësit që nuk do ta marrin maturën profesionale në përfundim të kësaj procedure kualifikimi do të mund të paraqiten në provimet që do të zhvillohen në gusht. Nxënësi që përsërit procedurën e kualifikimit paraqitet në provime në të gjitha apo në një pjesë të degëve nëse nota përfundimtare e tyre është e pamjaftueshme. Nota e re përfundimtare e çdo dege përcaktohet atëherë nga nota e provimit. Nota e shkollës nuk merret parasysh. Sesioni i përsëritjes i muajit gusht do të llogaritet si procedura e parë e kualifikimit për maturën profesionale.

Po me shkollën e kulturës së përgjithëshme dhe maturat e specializuara si do të veprohet ?

Ne jemi në pritje të një vendimi ndërkantonal lidhur me to.

Si veprohet nëse një i ri në formim apo një anëtar i trupit mësimor paraqet shenja të gripit ?

Në rast ethesh e kolle, i riu apo anëtari i trupit mësimor duhet të rrijë në shtëpi. Në rast rëndimi të shenjave, ai kontakton mjekun trajtues.

A do të mbahen udhëtimet e klasave (kampet dhe ekskursionet shkollore) në Zvicër ?

Të gjitha këto veprimtari anulohen deri në fund të vitit shkollor.

A do të mbahen udhëtimet jashtë vendit ?

Udhëtimet studimore, kampet dhe ekskursionet e tjera jashtë vendit anulohen deri në fund të vitit shkollor.

Mënyrat e kthimit të shpenzimeve të udhëtimeve të anuluar janë në studim.

Si mund ta vlerësoj unë gjendjen time apo atë të rrethit tim?

[CoronaCheck-u](https://coronavirus.unisante.ch/) është një mjet për të bërë vlerësimin e shpejtë të rrezikut tënd apo të njerëzve të rrethit tënd, dhe për të mësuar si të veprohet (<https://coronavirus.unisante.ch/>).

A keni ndonjë pyetje për të cilën nuk keni gjetur përgjigje në këtë FAQ ?

Mund të thërrisni njërin prej numrave të mëposhtëm :

- Prindërit që hasin në vështirësi edukative me fëmijët e tyre : **021 644 20 32** nga ora 8.00 deri në orën 22.00, nga e hëna deri të premten ;
- Fëmijët dhe të rinjtë që përballen me vështirësi në jetën e përditshme : **147**, linjë e hapur 24 orë në 24 ;
- Pritja shkollore, shkollat private dhe veprimtari të jashtëshkollore : **021 316 30 21** nga ora 8.00 deri në orën 18.00, nga e hëna deri të premten ;
- Mësimi në largësi dhe pyetje të tjera mbi arsimin e detyrueshëm : **021 316 32 64** nga ora 8.00 deri në orën 18.00, nga e hëna deri të premten ;
- Arsimi i mesëm (nxënësit në formim profesional, gjimnazet) : **021 316 62 95** nga ora 8.00 deri në orën 18.00 nga e hëna deri të premten.



Département de la formation,
de la jeunesse et de la culture

Për të mësuar më shumë

[Këshillat e OFSP-së](#) të ripërtërira në kohë reale dhe linja “Infos coronavirus” : +41 58 463 00 00
(çdo ditë, 24 orë në 24)

“Hotline” kantonale për t’iu përgjigjur të gjitha pyetjeve të popullsisë lidhur me koronavirusin : 0800 316 800 (çdo ditë, nga ora 8.00 deri në orën 20.00)

Për të ndjekur zhvillimin e gjendjes e për të marrë përgjigje për pyetjet tuaja, shkoni në sitin <https://www.vd.ch/coronavirus> dhe në sitin e qendrës së formimit përkatëse.